

STATUTI I SHOQËRISË DHE AKTI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"tePazari.al" Sh.p.k

Shtetasi i huaj **Besnik Hajredini**, i lindur më 11.10.1988, në Mitrovicë, Kosovë, dhe rezident në Prishtinë, Kosovë, në Rrugën Ismail Dumoshi 2/2, Prishtinë, identifikuar me anë të letërnjoftimit me nr. ID1070547, dhe nr. personal 1500998381, të lëshuar nga autoritetet e Republikës së Kosovës, madhor me zotësi të plotë për të vepruar,

në cilësinë e ortakut themelues të shoqërisë, krijon:

Shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "tePazari.al" Sh.p.k, me seli në "Officina Innovation Lab", Rruga "Asim Vokshi", nr. 57, 1057, Tiranë, Shqipëri.

Statuti është akti bazë ku do të mbështetet themelimi i shoqërisë tregtare "tePazari.al" sh.p.k, si dhe zhvillimi i mëtejshëm i saj.

KREU I

NENI 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1.1 Ortaku i vetëm i kësaj shoqërie, është: **Z. Besnik Hajredini**, i cili zotëron 100 % të kapitalit të kësaj shoqërie.

NENI 2

EMËRTIMI I SHOQËRISË

2.1. Shoqëria mban emrin "tePazari.al" sh.p.k, dhe është person juridik shqiptar.

2.2. Kjo shoqëri e fiton personalitetin e saj juridik, me regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

2.3. Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në këtë akt.

NENI 3

SELIA E SHOQËRISË



3.1. Shoqëria "tePazari.al" sh.p.k, ka qendrën në adresën "Officina Innovation Lab", Rruga "Asim Vokshi", nr. 57, 1057, Tiranë, Shqipëri, dhe ka të drejtë për të hapur degë dhe zyra të përfaqësimit të tjera, në Shqipëri dhe jashtë saj.

3.2. Njësitë strukturore, degët dhe përfaqësitë e saj do të ndërtohen konform legjislacionit shqiptar në fuqi dhe me atë të vendeve të tjera ku ajo mund të hapë degë.

NENI 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

4.1. Qëllimi i shoqërisë është: të kryejë të gjitha aktivitetet që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë në veçanti: a) tregtimin me pakicë dhe shumicë të mallrave online, nëpërmjet e-mailit, rrjeteve sociale, internetit, apo çdo platforme tjetër teknologjike; b) marketingun online; c) marketingun digjital si dhe kryerjen e shërbimeve të konsulencës dhe organizimit tregtar të subjekteve tregtare, apo dhe konsulencës teknologjike për implementimin e sistemeve telematike dhe informatike në sektorët e informatikës dhe tregtisë; d) tregtimin dhe ndërmjetësimin për shitjen e tekstileve, veshjeve, këpucëve, produkteve ushqimore, pijeve, duhanit, një varieteti të ndryshëm mallrash; e) të gjitha aktivitet tregtare në lidhje me pasuritë e luajtshme, të paluajtshme dhe financiare të lidhura me objektin e veprimtarisë së kësaj shoqërie; f) kryerjen e veprimtarisë postare dhe të korrierit, si dhe të magazinimit apo ruajtjes së mallrave, produkteve apo pajisjeve të ndryshme; g) shitjen, blerjen, marrjen hua, dhënien apo marrjen me qira të pasurive të luajtshme apo të paluajtshme dhe çdo gjë tjetër të nevojshme e të vlefshme për realizimin e drejtpërdrejte ose të tërthortë të qëllimit të shoqërisë; j) për realizimin e objektit shoqëria mund të kryejë, në rrugë ndihmëse të gjitha aktivitetet tregtare, industriale, financiare, ato lidhur me pasuritë e luajtshme apo të paluajtshme (përfshijtur mbledhja e kursimeve) të dobishme dhe/ose të nevojshme, etj, apo dhe konsulencën dhe shërbime profesionale në fushën marketingut, publicitetit, financiare, ligjore, burime njerëzore etj, si dhe importimin dhe eksportimin, me shumicë dhe pakicë të çdo shërbimi, malli, pajisje/makineri apo çdo gjëje tjetër që mund të nevojitet apo që mund të jetë me interes në lidhje me ushtrimin e çdo aktiviteti të ligjshëm; l) tregtimi dhe ndërmjetësimi për shitjen me shumicë e pakicë i artikujve të ndryshëm kozmetikë, pjesë dhe aksesore për automjete dhe produkte të tjera industriale; k) të shërbejë si përfaqësuese shitje e marketingu, agent shitje për shoqëri vendase dhe të huaja, apo çdo gjëje tjetër që mund të nevojitet apo që mund të jetë me interes në lidhje me ushtrimin e çdo aktiviteti të ligjshëm.

4.2. Shoqëria mund të hapë gjithashtu zyra dhe degë në çdo vend tjetër në botë ku do ta ketë të mundur, apo të përmbushë të gjitha levizjet tregtare, industriale, financiare, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme të nevojshme, ose që konsiderohen të dobishme për arritjen e qëllimit të saj: mund të kontraktojë kredi dhe financim në



përgjithësi, mund të marrë përsipër interesa të tjera, kuota/ aksione, pjesëmarrje në kapitalet e shoqërive të tjera apo dhe kompani të cilat kanë aktivitet tjetër social direkt apo indirekt, pa pasur për qëllim vendosjen tek palët e treta.

4.3. Aktivitetet e sipërpërmendura do të realizohen duke respektuar legjislacionin shqiptar në fuqi dhe konform me programin e aktivitetit ekonomik dhe financiar, të miratuar nga Ortaku/Ortakët e saj.

4.4. Shoqëria mund të zgjerojë ose kufizojë fushën e veprimtarisë së saj në çdo kohë.

NENI 5

PËRGJEGJËSIA E ORTAKUT TË SAJ

5.1. Pjesëmarrja në shoqëri nuk pengon pavarësinë ligjore, organizative dhe të pronësisë së ortakut të saj.

5.2. Ortaku i kësaj shoqërie, nuk është përgjegjës për detyrimet që lindin gjatë aktivitetit tregtar të shoqërisë, tej kapitalit themeltar të saj, që vetë ai e ka nënshkruar. Gjithashtu shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet personale të ortakut të saj.

NENI 6

KOHEZGJATJA

6.1. Shoqëria do të ushtroje aktivitetin ekonomik të saj, për një periudhë kohe të pakufizuar nga data e regjistrimit të saj.

NENI 7

SIMBOLET E SHOQËRISË

7.1. Shoqëria do të ketë vulën e saj "tePazari.al" sh.p.k. dhe akronim të saj TP.al

KREU II

NENI 8

KAPITALI I SHOQËRISË

8.1. Kapitali i nënshkruar i shoqërisë "tePazari.al" sh.p.k përbëhet nga para me vlerë të barabartë me 100.000 (njëqind mijë) lekë, e barabartë me 1 kuotë/pjesë me vlerë nominale 100.000 lekë, (1 kuotë/pjesë e barabartë me 100 % të kapitalit).

8.2. Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).



8.3. Kontributi i ortakut **Besnik Hajredini**, i nënshkruar prej tij, është 100.000 Lekë (njëqind mijë) Lekë, barabartë me 1 pjesë, e barabartë me vlerë nominale 100.000 Lekë e cila përbën 100 % të vlerës së kapitalit.

8.4. Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

NENI 9

TRANSFERIMI I KAPITALIT DHE I KUOTAVE

9.1. Kapitali themeltar ose pjesë të veçanta të tij, janë të transferueshme nga ortakut tek të tretët. Transferimi i kapitalit apo pjesëve të tij nga Ortaku në favor të të tretëve, kryhet gjithnjë me akt noterial të posaçëm.

9.2. Shoqëria mund të zmadhojë kapitalin themeltar ose mund ta zvogëlojë atë, por në çdo rast jo nën kufirin e përcaktuar ligjor. Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit behet me vendim të ortakëve të shoqërisë dhe sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

9.3. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe në shërbime, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute në natyrë sipas kërkesës së administratorit.

9.4. Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të ortakëve të shoqërisë në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

9.5. Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar.

NENI 10

TRANSFERIMI I KUOTAVE

10.1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

10.2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.



10.3. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të kuotave në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

10.4. Kalimi i kuotave kushtëzohet nga e drejta e parablerjes së tyre, nga ortakët e tjerë të shoqërisë.

KREU III

NENI 11

ORGANI VENDIMMARRËS

11.1. Asambleja e kësaj shoqërie është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë, që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

11.2. Ortaku/ët i/e saj, vendosin për çështje si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve;
- g) ndryshimin e statutit, e selisë së shoqërisë, hapjen dhe mbylljen e filialeve të saj.
- h) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë;
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë etj.

11.3. Të gjitha vendimet e marra nga Ortakët e saj duhet të regjistrohen në regjistrin e vendimeve, të dhënat e të cilit, nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Në regjistrin e vendimeve, duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- d) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

11.4. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.



11.5. Shoqëria nuk mund t'i kundërshtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

NENI 12

ADMINISTRATORI

12.1. Administratori i shoqërisë "tePazari.al" sh.p.k. është: Zj. **Lea Sopjani**, shtetase kosovare, lindur më 20.04.2001, në Prishtinë, mbajtëse e letërnjoftimit nr. ID1057753 dhe nr. personal 1176035575, lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Republika e Kosovës.

12.2. Administratori i shoqërisë do të ushtrojë kompetencat e administrimit për një afat 5 vjeçar, me të drejtë ripërtëritje bazuar në nenin 95/1 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

12.3. Administratori i kësaj shoqërie ka të drejtë që, në ushtrim të kompetencave të administratorit, që të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme pranë çdo institucioni privat apo publik, si dhe të marrë të gjitha vendimet në interes të shoqërisë.

12.4. Administratori i shoqërisë mund të caktohet edhe një person tjetër, jashtë ortakut.

NENI 13

KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATORIT

13.1. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga ai vete.
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) të përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakut të shoqërisë.
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raportojë përpara ortakut në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me



MBARIMI I SHOQËRISË

- 16.1.** Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet:
- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
 - b) me vendim të ortakëve të shoqërisë;
 - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar;
 - d) me vendim të gjykatës;

16.2. Në këtë rast ortaku i shoqërisë merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe duke shënuar në çdo dokument të shoqërisë emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

16.3. Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueuse, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

16.4. Nëse ortakët e shoqërisë nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

NENI 17

TRANSFORMIMI I SHOQËRISË

17.1. Transformimi i shoqërisë bëhet me vendim të ortakut të shoqërisë ose kur ekzistojnë faktorë të jashtëm detyrues ligjor. Në këto raste vendimi merret pasi administratori të ketë paraqitur një raport mbi gjendjen e shoqërisë.

17.2. Çdo transformim i bërë në kundërshtim me këtë nen është i pavlefshëm.

NENI 18

BAZA LIGJORE

18.1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

18.2. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar, Kodit Civil dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të dalë në zbatim të tyre në Republikën e Shqipërisë.



NENI 19

MOSMARRREVESHJET

19.1. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lind midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të tentohet të zgjidhen me konsensus dhe mirëkuptim.

19.2. Në rast të kundërt, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

NENI 20


DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

20.1. Ky statut është hartuar me vullnetin e lirë dhe të plotë të ortakut të shoqërisë dhe është nënshkruar prej tij.

20.2. Ky Statut u redaktua në gjashtë kopje, në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë juridike. Një kopje mbahet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

ORTAKU THEMELUES

Z. Besnik Hajredini

Besnik Hajredini


03/02/2021